



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 29, Datë 04.02.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET MARRËVESHJES SIGURUESE) TË ASETEVE
FIKSE TË SAJ, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN
BANK” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 2, gërma “a”, 3, 4, gërmat “a” dhe “b”, 5, gërma “j”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 62/2 prot., datë 29.01.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për barrësimin e aseteve fikse të saj, në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023 për centralin fotovoltaike me kapacitet 50 MW, në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Shoqëria me shkresën nr. 62/1 prot., datë 19.01.2026 ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të të licensuarit, si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Raiffeisen Bank sh.a.
- Kërkesa e mësipërme, ka ardhur në rrethanat kur më herët nga shoqëria është përcjellë shkresa nr. 3109 prot., datë 22.12.2025, me anë të të cilës është kërkuar vetëm marrja e

autorizimit për barrësimin e kuotave, por sa konstatuar nga ana jonë në dokumentacionin e përcjellë, rezulton se kredimarrësi detyrohet dhe garanton të paraqesë në favor të bankës *aprovimet përkatëse në lidhje me kuotat dhe transferimin e asteve të parkut fotovoltaiik*. Ndaj, ERE me shkresën nr. 62 prot., datë 08.01.2026, i ka sjellë në vëmendje të shoqërisë se në referencë të nenit 4, gërma “b” dhe nenit 2 të Rregullores me nr. 119/2016, jep miratimin për transferimin e aseteve fikse të të licencuarit të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së licencuar, me vlerë më të madhe se 150,000,000 lekë, si e tillë, ju kërkua depozitimi i aplikimit përkatës dhe dokumentacionit referuar nenit 7 të Rregullores 119/2016 në fuqi.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 5, gërma “j” dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare aktuale të saj dhe efektin që parashikon pas miratimit të transferimit të aseteve.
- **gërma “d”**: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve (Raiffeisen Bank sh.a.).
- **gërma “i”**: Shoqëria duhet të paraqesë deklaratën, që të shprehë gadishmërinë e bankës për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar, në rast të transferimit të aseteve.
- **gërma “j”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka patur transferime të kryera më herët nga ana saj.
- **Pika 6**: Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t’i kërkohej kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., që rrjedhin nga kontratat e kredive nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 06.10.2023 dhe nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, si dhe nga marrëveshja siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI